

**Ministria e Punëve të Jashtme  
Këshilli i Europës  
Organizon konferencën me temë:**

***Përmirësimi i cilësisë së zbatimit të KEDNJ nëpërmjet zgjerimit  
të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve vendase  
26-27 shtator 2007***

**Kontrolli kushtetues i pajtueshmërisë së legjislacionit shqiptar me  
standardet e KEDNJ**

**Dr. Vladimir Kristo  
Kryetar i Gjykatës Kushtetuese**

Pas ratifikimit të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, në Shqipëri ndodhën ndryshime pozitive në rendin kushtetues dhe ato, hapën rrugën drejt forcimit të shtetit ligjor. Më parë dispozitat kryesore kushtetuese dhe më pas Kushtetuta e vitit 1998, sanksionuan të drejtat dhe liritë themelore të individit dhe krijuan mjetet e nevojshme për të garantuar ushtrimin efektiv të tyre.

Në këto procese, duke zënë një vend të rëndësishëm, u përfshi dhe Gjykata Kushtetuese. Kontrolli i pajtueshmërisë së legjislacionit me standardet e KEDNJ-së përbën detyrën parësore të Gjykatës Kushtetuese. Sipas nenit 131 të Kushtetutës, GJK vendos, ndër të tjera, "*për pajtueshmërinë e ligjit me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare*" (siç parashikohet në nenin 122). Në larinë e çështjeve të kontrollit kushtetues të legjislacionit, një vend të posaçëm zënë vendimet për çështje të respektimit të standardeve të të drejtave të njeriut siç parashikon KEDNJ. Nëpërmjet veprimtarisë vendimmarrëse, GJK ka dhënë kontribut të qenësishëm për rritjen e përgjegjësisë së institucioneve drejt përbushjes, gjithnjë e më shumë, të standardeve evropiane për respektimin e të drejtave dhe lirive të individit.

Kushtetuta dhe KEDNJ kanë qark shumë pika takimi, sa që të arrijsh në përfundimin se një ligj është i pajtueshëm me Kushtetutën, pa hezitim mund të thuash se ai është i pajtueshëm edhe me standardet e KEDNJ-së. Megjithatë përputhshmërinë, njohja dhe reflektimi me standardet e KEDNJ-së dhe me jurisprudencën e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut përbën një domosdoshmëri. Veçanërisht jurisprudenca e GJEDNJ përbën një eksperiencë të çmuar për reflektimin dhe pasqyrimin deri në perfeksion të standardeve të Konventës.

Çështjet e kontrollit të pajtueshmërisë së ligjit me KEDNJ dhe me idetë udhërrëfyese të jurisprudencës së GJEDNJ kanë qenë dhe janë një proces sa delikat aq dhe i rëndësishëm i veprimtarisë vendimmarrëse të GJK. Duhet të konsiderohet fakti, se Gjykatës i është dashur, përgjatë pak vitesh ekzistencë, të krijojë eksperiencën e saj dhe ta pasurojë atë gradualisht, gjë që nuk është bërë pa vështirësi e pengesa. Në shumë raste, asaj i është dashur të çelë shtigje të reja, të krijojë e të përsosë jurisprudencën si garante e respektimit të Kushtetutës, duke reaguar kundër çdo akti ligjor antikushtetues.

Dhe tani më lejoni t'i referohem jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese për disa çështje të pajtueshmërisë së ligjit me Kushtetutën dhe me KEDNJ-në.

### *1. E drejta e jetës dhe respektimi i dinjitetit njerëzor.*

Është i njohur nga të gjithë vendimi nr. 65 datë 10.12.1999 i Gjykatës, me të cilin ajo deklaroi si të pajtueshëm me Kushtetutën dënimin me vdekje në kohë paqeje që parashikohej në dispozitat e Kodit Penal. GJK arsyeton në vendim, se dënimi me vdekje, "... i *analizuar sipas frymës së Kushtetutës dhe të KEDNJ, është i pajtueshëm me thelbin e këtyre të drejtave dhe lirive. Ai është mohim i të drejtës për jetën dhe përbën në vetvete një dënim çnjerëzor e mizor, që shteti e realizon me anë të pushtetit gjyqësor të tij. Dënimi kapital nuk ka të bëjë me kufizimin, por me eliminimin përfundimisht të subjektit nga shoqëria.*" Mbështetur në nenin 17, pika 2 të Kushtetutës, që nuk lejon për asnjë rast, kufizime të lirive dhe të drejtave të njeriut që mund të tejkalojnë kufizimet e

parashikuara në KEDNJ, GJK arriti në përfundimin, se dënimi me vdekje përbënte tejkalim të frymës së Kushtetutës dhe KEDNJ. Ka qenë ky, vendimi që i hapi rrugën procedurave të ratifikimit të Protokollit shtesë nr. 6 të KEDNJ, gjë të cilën Shqipëria ishte angazhuar ta realizonte brenda një afati trevjeçar pas nënshkrimit të saj. Deklarimi antikushtetues i dënimit me vdekje ishte, ndër të tjera, një konfirmim i vendosmërisë për të vënë në jetë KEDNJ. Për të arritur në këtë përfundim, GJK u mbështet edhe në jurisprudencën e gjykatave kushtetuese të vendeve të tjera.

## *2. E drejta e ankimit ndaj vendimeve (neni 6, neni 13 i KEDNJ)*

Në vendimin nr.25 datë 13.02.2002, GJK ka deklaruar antikushtetues pikën 2 të nenit 34 të ligjit nr.8737 datë 12.02.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në RSH”, sipas të cilit, “dekreti i Presidentit të Republikës për shkarkimin nga detyra është i paankimueshëm”. GJK arsyeton, se “... e drejta e ankimit pranohet si e drejtë themelore nga KEDNJ dhe se ushtrimi i kësaj të drejte është i pakufizuar”. Pika 2 e nenit 34 të ligjit, objekt kontrolli kushtetues, kishte vendosur kufizime lidhur me të drejtën e prokurorëve për tu ankuar ndaj vendimit të shkarkimit. GJK shprehet, se kufizimi i parashikuar me ligj kishte tejkaluar kufizimet që parashikon KEDNJ dhe neni 17 i Kushtetutës. Pas këtij vendimi, ligjvënësi ka bërë ndryshimet e duhura, duke plotësuar dispozitën përkatëse në përputhje me përmbajtjen e këtij vendimi.

Në frymën e zbatimit të jurisprudencës së GJEDNJ, GJK ka tërhequr vëmendjen, se KEDNJ vendos standardet dhe jep garancitë e domosdoshme, të cilave duhet t’u përmbahet çdo shtet kontraktues për të realizuar procesin e rregullt ligjor, por ajo nuk tregon rrethin e personave që përfitojnë prej tyre. Gjykata Kushtetuese “... çmon se procesi i rregullt ligjor zbatohet për të gjitha konfliktet që janë vendimtare për pozicionin juridik të një personi, qoftë edhe kur ky është funksionar publik”. GJK ka vërejtur, se e drejta e individit për një proces të rregullt ligjor nuk kufizohet vetëm me procesin gjyqësor, por edhe në atë me karakter disiplinor administrativ<sup>1</sup>. Në këtë rast, GJK i referohet vlerësimeve që ka

<sup>1</sup> Vendime të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, 2002, Tiranë, faqe 111.

dhënë në një vendim të mëparshëm lidhur me kuptimin e të drejtës për një proces të rregullt duke arsyetuar se “... njohja paraprake e personit, ndaj të cilit kërkohet marrja e masës së shkarkimit, me materialet që e ngarkojnë atë me përgjegjësi, respektimi i të drejtës për t’u dëgjuar e mbrojtur ... përbëjnë disa nga elementet bazë që garantojnë të drejtën kushtetuese për një proces të rregullt..” dhe, se mosrespektimi i tyre përbën shkelje të Kushtetutës dhe të KEDNJ.<sup>2</sup>

Në kontrollin kushtetues që ajo u ka bërë disa dispozitave të ligjit nr.7928 datë 27.04.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, GJK ka zbërthyer mirë dhe në detaje, mbështetur dhe në praktikën e GJEDNJ, kuptimin dhe fushën e zbatimit të së drejtës së ankimit, në të cilin ajo ka saktësuar, se “... e drejta e ankimit presupozon të drejtën e qytetarit për t’iu drejtuar një organi më të lartë shtetëror, shqyrtimin e ankimit, ekzistencën e organit për shqyrtimin e ankimit, afatet optimale të shqyrtimit, shqyrtimin objektiv, kontrollin gjyqësor si kontroll përfundimtar ndaj ankimit dhe garanci për rehabilitim të mundshëm si pasojë e pranimit të ankimit.”<sup>3</sup>

Në vendimin nr.15 datë 17.04.2003, duke deklaruar se shtesa e bërë në një dispozitë të Kodit të Procedurës Penale është në kundërshtim me nenin 17 të Kushtetutës dhe me kufizimet e parashikuara në KEDNJ, GJK konkludon, se personit të pandehur i cenohet e drejta e ankimit në rast se kërkohet që akti i përfaqësimit të lëshohet vetëm prej tij. Respektimi i të drejtës së mbrojtjes përbën kriter të rëndësishëm për të çmuar nëse ligji procedural është ose jo i pajtueshëm me Kushtetutën dhe me standardet e KEDNJ.

Duke rrëzuar kërkesën e Komitetit Shqiptar të Helsinkit, sipas së cilës duhen deklaruar në kundërshtim<sup>4</sup> me Kushtetutën dispozitat e K.Pr.P. që përcaktojnë detyrimin për t’u mbrojtur me avokat kur çështja shqyrtohet në Gjykatën e Lartë, GJK i referohet jurisprudencës së GJEDNJ<sup>5</sup>, në të cilën është konsoliduar pikëpamja, se merr rëndësi të veçantë për interesat e individit,

<sup>2</sup> Po aty, faqe 113.

<sup>3</sup> Vendime të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, 2003, Tiranë, faqe 40

<sup>4</sup> Vendime të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, 2003, Tiranë, faqe 92

<sup>5</sup> Airey kundër Irlandës, në “Për një rend publik evropian”, Tiranë 2001, faqe 517

Sutter kundër Zvicrës; Monelli & Morris kundër Mbretërisë së Bashkuar; Pakelli kundër Gjermanisë, etj.

në “Për një rend publik evropian”, Tiranë 2001, faqe 816

6. Vendime të Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë, 2006, Tiranë, faqe 181

garantimi i *karakterit efikas dhe cilësor të mbrojtjes*, veçanërisht në çështje penale. Sipas kësaj jurisprudence del, se për të konkluduar nëse procesi ka qenë i drejtë ose jo, siç përcaktohet në nenin 6 të KEDNJ, është e nevojshme që *analiza të jetë e gjithanshme, të përfshijë të gjitha shkallët e gjyqimit të çështjes*.

### 3. *Liria e veprimtarisë ekonomike private, liria e profesionit*

Në vendimin nr.30, datë 11.07.2006. GJK pasi analizon përmbajtjen e nenit 49 të Kushtetutës me frymën e qëndrimeve të mbajtuara nga GJEDNJ thekson, se përcaktimi i dhënë me Kushtetutë i të drejtës për punë përmban “...një detyrim pozitiv që kërkon një angazhim shtetëror për të krijuar kushte të përshtatshme për realizimin e kësaj të drejte....dhe një detyrim negativ që kërkon mosndërrhyrjen e shtetit për të cenuar këtë të drejtë”<sup>6</sup>.

Duke deklaruar antikushtetutshmërinë e vendimeve të KM, objekt kontrolli, GJK ka evidentuar “... *jo vetëm faktin se ato kanë efekt edhe për marrëdhëniet e punës të krijuara më parë, por edhe për shkak të mosrespektimit të parimit të proporcionalitetit ...*”, parim që është lëvruar në gjithë gjerësinë e tij nga praktika e GJEDNJ. Me këtë rast, GJK ka analizuar elementet përbërës të këtij parimi që duhen marrë në konsideratë nga organet shtetërore.

Në të njëjtin vendim, duke rrëzuar pretendimin e kërkuarit lidhur me interpretimin e zgjeruar që ai i ka bërë togfjalëshit “*vetëm me ligj*” për kufizimet që mund t’u bëhen të drejtave dhe lirive të parashikuara në Kushtetutë (neni 17), GJK ka vërejtur me maturi, se “*një interpretim i tillë i normave kushtetuese mund të lejohet vetëm në aspektin pozitiv, kur ky interpretim shkon në favor të mbrojtjes së të drejtave dhe jo e kundërta siç ka ndodhur në rastin që shqyrtohet.*”<sup>7</sup>

### 4. *Pavarësia e gjykatës dhe e gjyqtarit, masat disiplinore ndaj gjyqtarit*

KEDNJ nuk parashikon shprehimisht të drejta dhe garanci për ushtrimin e detyrës së gjyqtarit. Megjithatë, në shqyrtimin e disa çështjeve, GJK ka bërë vlerësime për pozitën e gjyqtarit duke marrë shkas nga formulimi i nenit 6.1, të KEDNJ, i cili sanksionon të drejtën e individit që çështja e tij të shqyrtohet “...

*nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e njohur me ligj, ...*. Në veprimtarinë vendimmarrëse të saj, GJK u është referuar rekomandimeve të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës si dhe deklaratave të Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Evropianë, lidhur me pozitën e gjyqtarit dhe parimet themelore të statusit të tij. Në vendimin nr.11 datë 27.05.2004, duke rrëzuar kërkesën për të deklaruar antikushtetues disa dispozita të ligjit nr.8678 datë 14.05.2001 “Për organizimin e Ministrisë së Drejtësisë” dhe të ligjit nr. 8811 datë 17.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, GJK ngulmon në kuptimin e gjithanshëm të rregullimit të bërë në nenin 145 të Kushtetutës ku thuhet, se gjyqtarët janë të pavarur dhe i nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve. Mbështetur në dokumentet e lartpërmendura, GJK vëren se “... *asnjë pushtet tjetër nuk mund të funksionojë si gjykatë ose të ushtrojë detyrën e gjyqtarit, ... askush nuk mund të ndërhyjë në dhënien e drejtësisë dhe se ... askujt nuk i lejohet të vërë në diskutim njohjen dhe vlerën e vendimeve gjyqësore ose të refuzojë ekzekutimin e tyre pasi ato kanë marrë formë të prerë.*”<sup>8</sup>

Gjatë ushtrimit të kontrollit kushtetues të një dispozite të ligjit nr. 8811 datë 17.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e KLD”, GJK ka konstatuar, se në raport me KEDNJ dhe me jurisprudencën e GJEDNJ<sup>9</sup>, *Kushtetuta ofron standarde më të larta të*

---

7.Vendime të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, 2006, Tiranë. faqe 183;

8.Vendime të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, 2004, Tiranë, faqe 79;

9. Çështja Devlin kundër Mbretërisë së Bashkuar, vendim nr. 29545/95, dt.31.10.2001 i GJEDNJ.

*mbrojtjes ndaj masës së shkarkimit nga detyra të gjyqtarit* ngaqë kjo masë shoqërohet edhe me mjetin e ankimit në Gjykatën e Lartë<sup>10</sup>.

Ndërsa, në vendimin nr. 18 datë 14.05.2003, “Për komisionet hetimore”, GJK tërheq vëmendjen për domosdoshmërinë e respektimit të *pavarësisë së gjykatave dhe gjyqtarëve*. GJK çmon që raporti përfundimtar i komisionit hetimor duhet të shmangë rrezikun e ndikimit që mund të ushtrojë në dhënien e

drejtësisë nga gjykatat. Këto të fundit, mund të ndikohen nga përfundimet e nxjerra në raportin përfundimtar të hetimit parlamentar.

Mbështetur në jurisprudencën e saj, GJK ka konkluduar, se dispozita e ligjit për “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në RSH” që parashikon masën e shkarkimit të gjyqtarit për shkelje të disiplinës është e papajtueshme me nenin 147, pika 6, e Kushtetutës. Ajo çmon, se “shkarkimi nga detyra i gjyqtarit, e drejta e ankimit ndaj këtij vendimi si edhe organi që duhet ta marrë këtë në shqyrtim rregullohen drejtpërdrejt nga Kushtetuta...” dhe kjo përbën shprehje të një garancie suplementare që i jepet atij për të ushtruar misionin e ngarkuar në pavarësi dhe paanësi të plotë<sup>11</sup>.

##### *5. E drejta respektimit të jetës private dhe familjare dhe e drejta për informim*

Në disa raste, Gjykatës Kushtetuese i është nevojitur të vërë në balancë dy të drejta, të sanksionuara në Kushtetutë dhe në KEDNJ dhe të përpunuara nga jurisprudenca e GJEDNJ. Në vendimin nr.16 datë 11.11.2004, GJK arsyeton, se zgjidhja e çështjes plekset me atë të përcaktimit të raportit midis dy të drejtave, përkatësisht të drejtës për informim dhe të drejtës për respektimin e jetës private (privatësia), të cilat interferojnë njëra me tjetrën. Gjykata thekson, se kufizimi i të drejtës së respektimit të jetës private në formën e deklarimit të pasurisë dhe mosmarrja paraprakisht e pëlqimit për publikim të të dhënave vetjake të këtij lloji përbën masë të parashikuar me ligj dhe se ligjvënësi, e ka çmuar me të drejtë si masë të domosdoshme për të mbrojtur interesa publike me të mëdha

---

10.Vendime të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, 2005, Tiranë, faqe 246;

11.Vendime të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, 2006, Tiranë, faqe 34.

të tilla si siguria kombëtare, mirëqenia ekonomike e vendit, mbrojtja e rendit kushtetues, parandalimi dhe ndëshkimi i veprave penale, mbrojtja e lirisë së të tjerëve etj.

Pasi pranon se të dhënat personale me karakter pasuror hyjnë në sferën e jetës private që mbrohen nga neni 35 i Kushtetutës dhe neni 8 i KEDNJ, Gjykata ka qenë në të njëjtën linjë arsyetimi me GJEDNJ duke vlerësuar, se ato nuk janë të dhëna “... me karakter sensitiv...” dhe pra “... nuk përbëjnë thelbin e jetës private dhe familjare”. Gjykata shton se “... marzhi i vlerësimit në këtë rast është dhe duhet të jetë shumë më i gjerë dhe tolerues, pasi bëhet fjalë për persona të rëndësishëm publikë, të veshur me pushtet të konsiderueshëm shtetëror”. Me këtë rast, GJK citon një argument nga jurisprudenca e GJEDNJ se, “publikimi i detajeve mbi të ardhurat ose pasurinë personale nuk përbën ndërhyrje në jetën private, veçanërisht nëse personi ushtron funksione publike ose pothuaj se publike”.<sup>12</sup> GJK ka argumentuar, se qëllimi i synuar ka justifikuar miratimin e ligjit objekt kontrolli, se mjetet e përdorura për arritjen e këtij qëllimi kanë qenë të ligjshme, se ligjvënësi ka treguar kujdes të respektojë parimin e proporcionalitetit duke balancuar të drejtën themelore për informim me detyrimin që kanë organet shtetërore për respektim të jetës private.

#### 6. E drejta respektimit të pronës private (n. 41.1 i Kushtetutës, n.1 Protokollit 1 i KEDNJ)

Në disa çështje, janë bërë objekt kontrolli kushtetues kërkesa që ngrenë pretendime për respektim të standardeve të procesit të rregullt ligjor në fushën e mbrojtjes së pronës në legjislacionin shqiptar. Duke iu referuar arritjeve më të mira të jurisprudencës në këtë fushë, GJK i është përmbajtur vlerësimit të bërë nga GJEDNJ, sipas së cilës, “E drejta e pronës nuk njejtësohet me të drejtën e kthimit të saj” dhe se kjo “... përbën kuptimin e nenit 1 të Protokollit 1 të KEDNJ, i cili mbron vetëm zotërimet ekzistuese të individit dhe nuk garanton të drejtën e fitimit të zotërimeve”. GJK ka vënë në dukje, se jurisprudenca evropiane për çështje të tilla “... i përmbahet qëndrimit se nuk përbën pasuri bindja për ekzistencën e të drejtës së pronësisë, e cila për një kohë të gjatë nuk është shfrytëzuar në mënyrë të efektshme”.<sup>13</sup>



12.Vendim i Gjykatës Franceze të Kasacionit, cituar nga GJEDNJ, në çështjen Frezzes&Roire kundër Francës, Aplikimi 29183/1995;

Ky nen i Konventës, garanton të drejtën e gjithsecilit për gëzimin në mënyrë paqësore të pasurive të tij, që rrjedhimisht përdoret vetëm për pasuritë ekzistuese të personit.<sup>14</sup> Në kuptim të kësaj dispozite, mbrojtja që garanton KEDNJ shtrihet për pasuri që janë kthyer në mënyrë përfundimtare si administrativisht ashtu edhe gjyqësisht dhe se pas kësaj, çdo ndërhyrje që prek padrejtësisht këtë pasuri i jep shkas kërkesës për zbatim të nenit 1, Protokollit 1 i KEDNJ.<sup>15</sup>

#### *7. E drejta e rehabilitimit dhe e zhdëmtimit për vendimet e padrejta*

Në vendimin nr. 34 datë 20.12.2005, GJK ka vlerësuar si antikushtetues nenin 1 të ligjit nr.9260 datë 15.07.2004 “Për statusin e ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë”. Në pjesën arsyetuese të vendimit, GJK është mbështetur në jurisprudencën e gjykatave kushtetuese të disa vendeve që përjetuan regjimin komunist të persekutimit të kundërshtarëve politikë. Kështu, ajo pranon, se *“Shteti demokratik i dëmshpërblen e kompenson këta persona sipas kushteve e mundësive ekonomike e financiare, duke u bazuar kryesisht në parimet e rëndësishme të drejtësisë dhe të barazisë”*<sup>16</sup>, dhe duke bërë këtë, ajo arrin në të njëjtin përfundim si edhe GJK e Hungarisë në shqyrtimin që kjo i ka bërë një çështje me natyrë të ngjashme.

\* \* \* \* \*

Për shkak të kohës së kufizuar ne trajtuam vetëm disa nga çështjet e jurisprudencës së GJK. Pjesë e kësaj jurisprudence janë dhe vendimet interpretuese të saj. Studimi i këtyre vendimeve tregon se trajtesat dhe arsyetimet e sjella në to janë mbështetur në standardet e KEDNJ dhe në jurisprudencën e gjykatave kushtetuese të vendeve evropiane.

---

13.Marek Antoni Novicki:Rreth Konventës Evropiane, faqe 344, referuar ne vendimin “Princi Frans-Adam II i Lihtenshtejnit kundër Gjermanisë, i datës 12.7.2001, Dhoma e Madhe, ankesa nr.42527/98, par.83;

14. Monica Carss-Frisk: E drejta e pronës Manuallet e të drejtave të njeriut, nr.4; Një udhëzues për zbatimin e nenit 1 të Protokollit 1 të KEDNJ, faqe 19;

15. Vendime të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, 2005, Tiranë, faqe 257.

16. Vendim nr.1, viti 1995 i Gjykatës Kushtetuese të Hungarisë.

Njëherësh, Gjykata Kushtetuese ndjek hap pas hapi zhvillimet më të fundit të jurisprudencës të GJEDNJ për procesin e rregullt dhe veçanërisht, të çështjeve me kërkues nga vendi ynë. Mbështetur në këto zhvillime, GJK ka pranuar, kur ka qenë rasti, kërkesat e individëve për shkelje të standardeve të procesit të rregullt ligjor dhe ka shfuqizuar vendimet përkatëse të gjykatave ose të organeve shtetërore. Pa folur për ndikimin që kjo ushtron në jurisprudencën e vet, GJK ka shërbyer si “filtër” për të riparuar shkeljet nëpërmjet shfrytëzimit efikas të mjeteve të brendshme të kontrollit për të përmbushur standardet e KEDNJ. Nga ana tjetër, kjo jurisprudencë i ka shërbyer asaj të njohë e të zbatojë më mirë, në shtrirje dhe në përmbajtje, standardet e KEDNJ për procesin e rregullt ligjor në veprimtarinë e saj vendimmarrëse. Po citoj si shembull çështjen *Qufaj kundër Shqipërisë*, në të cilën GJEDNJ theksoi, se mos *ekzekutimi i vendimeve civile përbën shkelje të standardeve të procesit të rregullt ligjor në kuptimin e nenit 6§1 të Konventës, gjë të cilën GJK e kishte konsideruar më parë kompetencë ekskluzive të gjykatave të zakonshme*. Pak kohë pas vendimit për çështjen Qufaj, në vendimin nr. 2 datë 31.03.2006, GJK çmoi se ankuesit i është cenuar e drejta kushtetuese për proces të rregullt ligjor, për shkak të mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë dhënë në favor të tij. Me këtë vendim, GJK jo vetëm pasuroi jurisprudencën e vet, *por ajo sensibilizoi mjedisin juridik, gjyqtarë, avokatë etj. për rëndësinë që merr ekzekutimi pa asnjë ekuivok dhe pa vonesë i të drejtës së fituar me vendim gjyqësor të formës së prerë. Mosveprimi për të ekzekutuar një të drejtë të fituar me ligj përbën gjithashtu shkelje të së drejtës për një proces të rregullt ligjor.*

E njëjta gjë mund të thuhet edhe për ndikimin që ka ushtruar ndaj veprimtarisë vendimmarrëse të GJK çështja *Balliu kundër Shqipërisë*, ku theksohet se “... autoritetet kompetente janë të detyruara të marrin masa për të siguruar se ankuesit gëzojnë efektivisht të drejtën e mbrojtjes.” Pas këtij vendimi,

GJK është kujdesur të shqyrtojë me këtë frymë çështjet që kanë ngritur pretendime për shkelje të së drejtës së mbrojtjes dhe, kur ka qenë rasti, ka shfuqizuar vendimet përkatëse për shkelje të standardeve që parashikohen nga neni 6 i KEDNJ dhe neni 42 i Kushtetutës.

\* \* \* \* \*

Së fundmi, pas paraqitjes të kësaj sinteze të jurisprudencës së GJK për çështje të kontrollit kushtetues të pajtueshmërisë së legjislacionit me standardet e KEDNJ-së, përfitoj nga rasti të trajtoj një problem, rëndësia e të cilit ka të bëjë me efektivitetin e veprimtarisë vendimmarrëse të Gjykatës Kushtetuese.

Në përputhje me Kushtetutën, Gjykata Kushtetuese ka vetëm kompetencën e shfuqizimit të akteve që shqyrton, pra, ajo vepron si ligjvënës negativ. Kjo do të thotë, se u takon organeve shtetërore përkatëse të plotësojnë boshllëkun ligjor që krijohet nga ky shfuqizim. Eksperienca 15 vjeçare e GJK ka treguar, se jo gjithnjë organet shtetërore veprojnë me shpejtësinë e duhur për të bërë plotësimet e legjislacionit dhe ç'është më keq, në raste të veçanta, ky plotësim nuk ka qenë në përputhje të plotë me konkluzionet dhe përmbajtjen e vendimeve të GJK.

Është e kuptueshme se legjislacioni që bie ndesh me standardet e KEDNJ-së cenon rëndë si të drejtat e njeriut, ashtu edhe interesat e shtetit të së drejtës. Sa më shumë të zgjasë zbatimi i një ligji antikushtetues aq më shumë do të cenohen këto interesa dhe aq më të rënda do të jenë pasojat që mund të vijnë, të cilat nuk mund të riparohen nga GJK edhe në rastet kur ligji shfuqizohet. Eksperienca e këtyre viteve tregon, se Gjykatës Kushtetuese i duhet të jetë e vëmendshme për të zbatuar, kur është rasti, kompetencën e saj ligjore të pezullimit të zbatimit të aktit normativ. Zbatimi i kësaj kompetence, ndryshe nga sa ka ndodhur në ndonjë rast, detyron organet shtetërore kompetente, të marrin urgjentisht masa për për ndërprerjen e gjendjes së paligjshmërisë në funksion të mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave themelore të shtetasve dhe të interesave madhore të shtetit shqiptar që aspiron të integrohet sa më parë në strukturat euroatlantike.

Faleminderit për vëmendjen tuaj.